



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

Tiranë, më 21.7.2020

KËRKESËPADI

Paditës: Dhoma Kombëtare e Përmbarduesve Gjyqësorë Privatë, person juridik i krijuar sipas ligjit nr. 10 031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbardimor gjyqësor privat”, i ndryshuar, e pajisur me NIPT: L21606451P, me seli në rrugën “Nikolla Jorga”, ndërtesa 9, kati i 2-të, Tiranë, përfaqësuar ligjërisht nga kryetari, z. Tedi MALAVECI.

I paditur: MINISTRIA E DREJTËSISË

Objekti: 1. Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke vendosur pezullimin e zbatimit të aktit administrativ, urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 190, datë 22.6.2020 “Për miratimin e listës së dokumenteve dhe formatit të vetëdeklarimit për rifreskimin e dosjeve personale të përmbarduesve gjyqësorë privatë.”

2. Shfuqizimi i aktit administrativ, urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 190, datë 22.6.2020 “Për miratimin e listës së dokumenteve dhe formatit të vetëdeklarimit për rifreskimin e dosjeve personale të përmbarduesve gjyqësorë privatë.”

Baza Ligjore: Nenet 7/a, 10/1, 11/1, 15, 17/a, 18,28, 29, 30 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurave Administrative; pika 7 e nenit 88 të ligjit nr. 26/2019, datë 8.5.2019 “Për shërbimin përmbardimor gjyqësor privat”.

Drejtuar: GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ADMINISTRATIVE

TIRANË



E nderuar Gjykatë!

Ministri i Drejtësisë ka nxjerrë urdhrin nr. 190, datë 22.6.2020 “Për miratimin e listës së dokumenteve dhe formatit të vetëdeklarimit për rifreskimin e dosjeve personale të përmbaruesve gjyqësorë privatë”, urdhër i cili është nxjerrë në kundërshtim me dispozitën ligjore që autorizon ministrin e Drejtësisë në nxjerrjen e këtij akti administrativ.

I. PARASHTRIM I PIKAVE TË URDHRIT NR. 30, DATË 30.8.2018 QË JANË NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN

Po citojmë pikat e urdhrin nr. 190, datë 22.6.2020 “Për miratimin e listës së dokumenteve dhe formatit të vetëdeklarimit për rifreskimin e dosjeve personale të përmbaruesve gjyqësorë privatë”, të cilat janë në kundërshtim të hapur me ligjin që ka parashikuar vendimmarrjen e ministrit të Drejtësisë.

Dispozitat konkrete:

1. Titulli i urdhrin i formuluar në këtë mënyrë: “...për miratimin e listës së dokumenteve dhe formatit të vetëdeklarimit për rifreskimin e dosjeve personale të përmbaruesve gjyqësorë privatë...”;
2. Pika 3, shkronjat “c”, “d” dhe “e” të formuluar në këtë mënyrë:
“... c) Formular i vetëdeklarimit dhe dokumentacionin përkatës të kërkuar, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri;
d) Formulari i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, të plotësuar;
e) Formularin e vetëdeklarimit mbi fillimin, vijimin, pezullimin, masat disiplinore ose shkëputjen nga ushtrimi aktiv i veprimtarisë përmbarimore, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij urdhri...”
3. Pika 5, është formuluar në këtë formë
“...Pasqyrimi i të dhënave të rreme në formularët e vetëdeklarimit, fshehja ose mosdeklarimi i të dhënave që janë të detyrueshme për t’u deklaruar sipas këtij urdhri ose ligjit për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat pavarësisht nëse përbën vepër penale, në çdo rast përbën shkak për nisjen e procedimit disiplinor...”;
4. Pika 12, është formuluar në këtë formë:
“...Ky urdhër publikohet për njohje në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe i përcillet Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, për bërjen e njoftimeve pranë përmbaruesve gjyqësorë privatë, mbi detyrimin për rifreskimin e dosjeve personale dhe dorëzimit të formularëve të vetëdeklarimit, brenda afateve të përcaktuara në këtë urdhër...”.

Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, në cilësinë e palës paditëse në këtë proces, kërkon shfuqizimin e këtij akti administrativ dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë për shkak të shkeljes së parimit të ligjshmërisë dhe shkeljes së procedurës për nxjerrjen e urdhrin, që detyron përmbaruesit gjyqësorë privatë të zbatojnë një akt normativ në kundërshtim me qëllimin

dhe autorizimin e ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat” dhe refuzimi i zbatimit të të cilit do të sillte pasoja të paligjshme për të gjithë përmbaruesit gjyqësorë privatë. Konkretisht, nisjen e procedimit disiplinor për secilin prej tyre.

II. ARSYETIMI LIGJOR MBËSHTETUR MBI PROVA

i. Legjitimimi i Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë në procesin gjyqësor administrativ para Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, përfaqëson bashkimin e detyrueshëm të të gjithë përmbaruesve gjyqësorë privatë të licencuar. Si rrjedhim, ky subjekt juridik i krijuar për shkak të ligjit, nëpërmjet tagrave që i ka dhënë pika 1, 2 dhe shkronja “ç”) e pikës 5 e neni 29 të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, legjitimohet të ushtrojë të drejtën e padisë, konform neni 15 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, si një subjekt që përfaqëson të gjithë përmbaruesit gjyqësorë privatë të cilët preken drejtpërdrejt prej këtij akti administrativ.

Gjithashtu, Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë gjen legjitimim edhe konform neni 4, të Kodit të Procedurave Administrative, që parashikon se:

“Palë e interesuar në një procedurë administrative do të quhet çdo person fizik, juridik ose autoritet shtetëror, të drejtat ose kompetencat e ligjshme të të cilit, qofshin këto individuale ose të përbashkëta, kanë të ngjarë të preken gjatë procedurës administrative”.

Për sa më lart, në mënyrë kumulative plotësohen kushtet e legjitimitit të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë për të kërkuar shfuqizimin e urdhrit nr. 190, datë 22.6.2020 dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë, pasi:

- Ekziston veprimi administrativ i miratimit të urdhrit nga Ministria e Drejtësisë në cilësinë e organit publik qendror;
- Evidentohet shkelja e parimit të ligjshmërisë dhe të procedurës në nxjerrjen e aktit që e bën këtë urdhër absolutisht të pavlefshëm, paligjshmëri e cila prek në mënyrë të drejtpërdrejtë, secilin përmbarues në veçanti dhe të gjithë shërbimin përmbarimor gjyqësor privat, në përgjithësi.

Kërkimi i palës paditëse i drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si gjykata që ka kompetencën lëndore dhe kompetencën funksionale sipas neni 7 shkronja “a” dhe neni 10, pika 1, të ligjit nr. 49/2012, për gjykimin e mosmarrëveshjeve me objekt aktet nënligjore individuale. Urdhri nr. 190, datë 22.6.2020 konsiderohet një akt nënligjor individual në kushtet kur përcakton rregulla të detyrueshme për secilin përmbarues, të evidentuar posaçërisht, anëtar të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.

ii. Urdhri nr. 190, datë 22.6.2020 është një akt administrativ i cili është nxjerrë në kundërshtim me procedurën ligjore të kërkuar për nxjerrjen e tij.

Neni 88/7 i ligjit nr. 26/2019, ka parashikuar në aspektin procedural të nxjerrjes së urdhrit të ministrit të Drejtësisë, si më poshtë:

“7. Çdo përmbarues gjyqësor privat dorëzon dosjen e plotë personale të rifreskuar pranë ministrisë, brenda 1 muaji nga miratimi i listës së dokumenteve dhe formatit të vetëdeklarimit nga ministri. Lista e dokumenteve që dorëzohen dhe formati i vetëdeklarimit të të dhënave të kërkuara përcaktohet me urdhër të ministrit, pas konsultimit me Dhomën, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji.”

Pra, sipas parashikimit eksplicit ligjor, miratimi i listës së dokumenteve dhe formatit të vetëdeklarimit nga ministri i Drejtësisë përcaktohet, pas konsultimit me Dhomën.

Kjo dispozitë evidenton qartë, detyrimin e zbatimit të saj nga ana e secilit përmbarues, por njëkohësisht edhe detyrimin e Ministrisë së Drejtësisë, (si organ kompetent në nxjerrjen e urdhrit), që veprimtarinë administrative duhet ta ushtrojë në përputhje me kërkesat e kësaj dispozite, ku e drejta e ministrit të Drejtësisë për miratimin e këtij akti, duhet të ndjekë një procedurë të caktuar, të detyrueshme nga ligji që përcaktohet në togfjalëshin: pas konsultimit me Dhomën.

Konsultimi, si një kërkesë ligjore procedurale, karakterizon gjithë përpunimin e legjislacioneve përëndimore, me profesionalizëm dhe me maksimumin e cilësisë. Për sintetizimin më të mirë të ideve dhe rrahjes së mendimeve për një akt apo çështje të caktuar që autorizon ligji deri në miratimin e tij, duhet konsultim ekspertize, sipas kuptimit: “Konsultimi= një takim me një ekspert për të kërkuar këshillë.”

Konsultimi, duhej të ishte takimi apo mbledhja ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, për të shkëmbyer mendime me specialistët apo ekspertët e fushës së përmbarimit, ku të shtroheshin për zgjidhje problemet apo të merreshin këshilla nga profesionistëve të fushës që janë pikërisht, përmbaruesit gjyqësorë privatë.

Por ky lloj konsultimi nuk ka ndodhur në asnjë rast për këtë akt. Nuk janë shkëmbyer në asnjë rast mendime apo konsultime komplementare me Ministrinë e Drejtësisë, por Dhoma Kombëtare vetëm ka dhënë propozime konkrete, pa marrë asnjë reagim ligjor institucional. Në datë 2.10.2019 Dhoma Kombëtare ka dërguar si propozim shkresën me nr. prot. 615 me lëndë *“Propozim për miratimin e formatit të vetëdeklarimit të të dhënave nga përmbaruesi gjyqësor privat dhe dorëzimit të dokumenteve për rifreskimin e dosjes personale në Ministrinë e Drejtësisë”*.

Asnjë përgjigje për muaj me radhë dhe asnjë KONSULTIM nuk është zhvilluar nga Ministria e Drejtësisë për këtë akt.

Mosrespektimi i këtij detyrimi ligjor, bën që akti nënligjor të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm, për shkak se nuk ka respektuar procedurën e nxjerrjes së tij.

Duhet theksuar se, respektimi i procedurës dhe **respektimi i procesit konsultues me Dhomën, është një kusht procedural për vlefshmërinë e aktit administrativ**; urdhër nr. 190, datë 22.6.2020.

Është fakt se, Ministria e Drejtësisë nuk është konsultuar dhe nuk ka kërkuar në asnjë rast të konsultohet me Dhomën, ashtu si parashikohet në ligj, përgjatë procesit përpunues, draftues deri miratues të urdhrit nr. 190, datë 22.6.2020.

Ministria e Drejtësisë ka detyrimin procedural, që të provojë para kësaj gjykate se e ka realizuar procesin konsultativ të nxjerrjes së aktit, duke zhvilluar apo kërkuar nëpërmjet ndonjë lloj komunikimi të njohur institucional si: shkëmbimi elektronik, tryeze konsultative, mbledhje diskutimore apo forme tjetër konsultimi sqarues - përpunues, shkëmbyer me Dhomën, përpara se të miratonte dhe nxirrte aktin administrativ, objekt gjykimi, me këtë përmbajtje.

Shkelja e procedurës në fazën e përgatitjes së aktit administrativ e bën aktin administrativ absolutisht të pavlefshëm në zbatim të nenit 108 shkronja “a”/ii të Kodit të Procedurave Administrative që ka parashikuar, se:

“...Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:

a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:

i) kompetencën e organit publik;

ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose

iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit;...”

Shkelja e kësaj procedure vlerësojmë se, është bërë në mënyrë të qëllimtë, për të mundësuar nxjerrjen e një akti që, nuk është në përputhje me qëllimin që ka përcaktuar dispozita ligjore që ka autorizuar ministrin e Drejtësisë për nxjerrjen e tij.

Konkretisht, neni 88/7 i ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, nuk ka autorizuar ministrin e Drejtësisë për të kryer “Vetting” të përmbartuesve gjyqësorë privatë nëpërmjet formularëve të vetëdeklarimit të përmbartuesve, por ka autorizuar përditësimin e të dhënave për dosjet personale nëpërmjet vetëdeklarimit të të dhënave të kërkuara.

Vetëdeklarim që lidhet me dorëzimin e të dhënave që duhet të qëndrojnë në dosjen personale të secilit përmbartues, dosje këto që Ministria e Drejtësisë duhet t’i kishte të administruara për secilin

përmbarues prej nga momenti që i ka certifikuar/licencuar në 10 vite rresht, por që, për shkak të vetë neglizhencës së saj institucionale, nuk e ka kryer apo përmbushur këtë proces, që s'mund të jetë kurrsesi një proces vetëdeklarues mbi vërtetësinë e të dhënave apo dokumenteve të dorëzuara një herë në rastin e fillimit të aktivitetit profesional me certifikimin e përmbaruesit gjyqësor privat.

Përfundimisht në këtë pikë, shkelja e procedurës ka ndikuar në ndryshimin e qëllimit të aktit sipas parashikimeve ligjore, devijimin e të cilit do ta parashtrojmë në vijim.

iii. Urdhri nr. 190, datë 22.6.2020 është një akt administrativ i cili është nxjerrë në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë të përcaktuar në nenit 4 të Kodit të Procedurave Administrative që derivon nga zbatimi i detyrueshëm i nenit 118 të Kushtetutës.

Neni 118 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si norma më e lartë juridike në hierarkinë e normave të rendit juridik në Republikën e Shqipërisë ka sanksionuar se:

“1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë. 2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.”.

Në vendimin e saj nr. 25, datë 28.4.2014 Gjykata Kushtetuese ka bërë interpretimin e paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 118 të Kushtetutës, duke theksuar interpretueshëm se,

“[...] Këto dispozita ndihmojnë për t'i dhënë kuptimin kushtetues dhe doktrinar konceptit “rezervë ligjore”, nëpërmjet të cilës kufizohet apo orientohet pushteti normativ i organeve ekzekutive për të rregulluar marrëdhënie të caktuara me akte nënligjore. Kjo rezervë ligjore krijon mundësinë që çështja konkrete e rregulluar pjesërisht me ligj të mund të detajohet më tej nga aktet nënligjore, duke iu përmbajtur parimeve dhe kufijve të përcaktuara nga ligji. Vetëm në këtë mënyrë autorizimi i ligjvënësit për nxjerrjen e akteve nënligjore mund të konsiderohet i realizuar brenda kufijve të kushtetutshmërisë [...]”.

Neni 88/7 i ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, ka parashikuar në aspektin procedural të nxjerrjes së udhëzimit të përbashkët si më poshtë:

“7. Çdo përmbarues gjyqësor privat dorëzon dosjen e plotë personale të rifreskuar pranë ministrisë, brenda 1 muaji nga miratimi i listës së dokumenteve dhe formatit të vetëdeklarimit nga ministri. Lista e dokumenteve që dorëzohen dhe formati i vetëdeklarimit të të dhënave të kërkuara përcaktohet me urdhër të ministrit pas konsultimit me Dhomën, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji.”

Ky rregullim ligjor nuk mund të trajtohet i veçuar nga neni 23 i ligjit nr. 26/2019, i cili ka përcaktuar në mënyrë shteruese nevojën për pasjen e dokumentacionit që përbën bazën e të dhënave të “Regjistrin të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë”, regjistër që publikohet dhe është i aksesueshëm për publikun, sikurse dhe “Regjistrin Unik të të Dhënave për Zyrat e Përmbarimit

Privat dhe Përmbauesit Gjyqësorë Privatë” që administrohet vetëm nga Ministria e Drejtësisë dhe nuk është i aksesueshëm për publikun.

Konkretisht, neni 23 i ligjit 26/2019 ka përcaktuar se :

“...1. Regjistri i Përmbauesve Gjyqësorë Privatë krijohet pranë ministrisë. Ky regjistër ruhet, mirëmbahet dhe përditësohet në format të integruar manual dhe elektronik nga strukturat përgjegjëse të ministrisë.

Ky regjistër përmban të dhënat publike si vijon:

- a) identiteti;*
- b) vendbanimi;*
- c) numri i licencës;*
- ç) data e fillimit të veprimtarisë përmbaimore;*
- d) Numri Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS);*
- dh) adresa e vendit, ku zhvillon veprimtarinë përmbaimore.*

2. Regjistri Unik i të Dhënave për Zyrat e Përmbaimit Privat dhe Përmbauesit Gjyqësorë Privatë krijohet, mirëmbahet dhe përditësohet nga ministria. Regjistri unik ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë regjistrohen të dhënat e përmbauesve gjyqësorë privatë si vijon:

- a) identiteti (emër, mbiemër, atësi, datëlindje, numri personal i identifikimit dhe fotografi);*
- b) adresa e vendbanimit;*
- c) numri i certifikatës së aftësisë profesionale ose licencës, sipas rastit, data, lloji i certifikimit /licencimit;*
- ç) Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIS);*
- d) data e fillimit të veprimtarisë përmbaimore;*
- dh) adresa e vendit ku zhvillon veprimtarinë përmbaimore;*
- e) adresa elektronike zyrtare, numri i kontaktit, çelësi publik elektronik;*
- ë) të dhënat për pezullimin e certifikatës/licencës;*
- f) të dhëna mbi masa disiplinore, nëse ka të tilla;*
- g) të dhënat e policës së sigurimit të veprimtarisë profesionale;*
- gj) të dhëna në lidhje me leje vjetore, studimore, mjekësore dhe pezullimit të përkohshëm nga veprimtaria përmbaimore;*
- h) të dhëna rreth arsimit universitar, si dhe certifikimit të njohurive të gjuhës së huaj, nëse ka;*
- i) numri i llogarisë së veçantë bankare për procedurat e ekzekutimit.*

3. Në pjesën e dytë regjistrohen të dhënat e zyrave të përmbaimit privat, si vijon:

- a) emri i zyrës së përmbaimit privat dhe të dhënat për ortakët/aksionarët dhe administratorin (emri, mbiemri, datëlindja, numri personal i identifikimit);*
- b) Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIS) dhe data e regjistrimit të aktivitetit;*
- c) adresa e selisë së zhvillimit të aktivitetit, adresa zyrtare elektronike, faqja zyrtare të internetit;*
- ç) të dhënat e personave të punësuar në zyrën e përmbaimit privat, sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij neni.*

4. Përmbaruesit gjyqësorë privatë dhe zyrat e përmbarimit privat deklarojnë regjistrimin e të gjitha të dhënave të parashikuara në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, në mënyrë të plotë dhe detyrohen t'i pasqyrojnë të dhënat sipas shkronjave "a", "b", "ç", "dh", "e", "g", "gj" dhe "i", të pikës 2, të këtij neni, për përmbaruesit gjyqësorë privatë dhe të dhënat e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, për zyrat e përmbarimit privat, duke i deklaruar pranë ministrisë jo më vonë se 10 ditë nga data e ndryshimit të tyre.

5. Regjistri i Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, sipas pikës 1 të këtij neni, qëndron në format elektronik të integruar dhe përditësohet me të njëjtat të dhëna në faqet zyrtare të Ministrisë dhe Dhomës.

6. Regjistri Unik i të Dhënave për Zyrat e Përmbarimit Privat dhe Përmbaruesit Gjyqësorë Privatë qëndron në ministri dhe informacioni mbi të dhënat, shënimet, ndryshimet dhe faktet e treguara në të autorizohen vetëm nga ministri.

7. Pranë ministrisë krijohet Regjistri i Ndhimëspërmbaruesve, i cili përmban të dhëna në lidhje me:

a) identitetin (emër, mbiemër, atësi, datëlindje, vendlindje, vendbanim dhe numër personal të identifikimit);

b) datën e fillimit të marrëdhënies së punës;

c) kontratën e punës;

ç) adresën e vendit, ku zhvillon aktivitetin;

d) vlerësimet nga përmbaruesit gjyqësorë privatë ku është punësuar.

8. Format i regjistrave të parashikuar në pikat 1, 2, 3 dhe 7 të këtij neni, mënyra e mbajtjes dhe përditësimit të të dhënave në to përcaktohen me urdhër të ministrit, pas marrjes së mendimit të Dhomës.

9. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale që ndodhen në regjistrat e ministrisë bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale...". ,

Në analizë të pikës 4 të nenit 23 dhe pikës 7 të nenit 88 të ligjit nr. 26/2019 konstatohet se, **ligji i ngarkon të gjithë përmbaruesit të deklarojnë regjistrimin e të gjitha të dhënave**, si ato të përgjithshme, ashtu dhe ato unike të konfidentalizuara, të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të nenit 23.

Për pasojë, qëllimi i urdhrat nuk duhej të synonte kryerjen e procesit të "vetingut" në shërbimin përmbarimor gjyqësor privat, por përditësimin e të dhënave nëpërmjet deklarimit të regjistrimit të tyre pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Për më tepër, nisur nga përmbajtja e urdhrat objekt ankimi, duam të vëmendësojmë Gjykatën se, **procese të llojit "vetting", janë procese që kryhen vetëm në raste përjashtimore, nën autorizime kushtetuese, nga organe të pavarura.**

Procesi i vlerësimit kalimtar – i ashtuquajtur "vetting", është një proces jo i zakonshëm, që duhet të kryhet për arsye madhore që lidhen me interesin publik dhe për këtë arsye, mund dhe duhet të jetë vetëm një proces rreptësishtë i përkohshëm. Kjo ka qenë dhe ideja e rivlerësimit kalimtar të

gjqtarëve dhe prokurorëve dhe po kështu është shprehur edhe **Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit – Komisioni i Venecias për këtë çështje.**

Komisioni i Venecias, në datën 19 qershor 2020, në opinionin e miratuar nr. 978/2020 për Shqipërinë “*Mbi emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese*”, si dhe në dy opinionet e mëparshme për këtë çështje¹, ka ripërsëritur qëndrimin se:

“Procesi shumë radikal i verifikimit (“vlerësimi i kualifikimit”) i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit i krijuar posaçërisht, mund të shihet si i përshtatshëm në kontekstin shqiptar, mbi bazën e supozimit - të përhapur gjerësisht - që niveli i korrupsionit në gjyqësorin shqiptar ishte jashtëzakonisht i lartë dhe kërkonte masa urgjente dhe radikale. Sidoqoftë, Komisioni këmbënguli që vettingu mund të ishte vetëm një masë e jashtëzakonshme dhe rreptësisht e përkohshme dhe Komisioni bëri një numër rekomandimesh në mbrojtje të këtij procesi. Procesi i verifikimit duhej të ishte “rreptësisht i përkohshëm”, që të mos ndodhte që strukturat e vettingut të zëvendësonin organet e zakonshme kushtetuese. Sidoqoftë, për Komisionin është e qartë se procesi i vetting duhet të zhvillohet sa më shpejt që të jetë e mundur, por duke siguruar një shqyrtim të drejtë të secilit rast.”

Pra, citimi i mësipërm nga Opinioni i Komisionit të Venecias, sillet në këtë gjykim, për të kuptuar paligjshmërinë e urdhrin të ministrit të Drejtësisë, të nxjerrë jo vetëm në shkelje të ligjit, por edhe jashtë çdo konteksti kushtetues dhe ligjor, tërësisht jashtë realitetit apo nevojës për të nxjerrë një urdhër me këtë përmbajtje.

Në urdhrin nr. 190, datë 22.6.2020, ministri i Drejtësisë ka urdhëruar dorëzimin e “Formatit të vetëdeklarimit për rifreskimin e dosjeve personale të përmbaruesve gjyqësorë privatë”, referuar titullit të urdhrin.

Titulli i urdhrin është në kundërshtim me vetë detyrimin e parashikuar në pikën 7 të nenit 88 të ligjit 26/2019 dhe, sidomos me qëllimin e vetë ligjit të parashikuar në pikën 4 të nenit 23.

Dallimi i qëllimit të ligjit me qëllimin e urdhrin ministror pasqyrohet veçanërisht në shkronjat “c” dhe “d” të pikës 3 të urdhrin 190, datë 22.6.2020, të cilat janë formuluar në këtë mënyrë:

“... c) Formular i vetëdeklarimit dhe dokumentacionin përkatës të kërkuar, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri;

d) Formulari i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, të plotësuar;...”

¹ CDL-AD (2015) 045, Opinion paraprak për projektndryshimet kushtetuese për gjyqësorin e Shqipërisë; CDL-AD (2016) 009, Opinion përfundimtar për draftin e rishikuar mbi ndryshimet kushtetuese për gjyqësorin (15 janar 2016) të Shqipërisë; CDL-AD (2016) 036, Shqipëri - Përmbledhje *Amicus Curiae* për Gjykatën Kushtetuese për ligjin për “*Rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve*” (Ligji i Vetting-ut).

Në këta formularë janë kërkuar të dhëna, të cilat administrohen nga vetë Ministria e Drejtësisë. P.sh të dhëna të tilla **si vetëdeklarimi i masave disiplinore**, të cilat janë akte që janë nxjerrë nga vetë Ministria e Drejtësisë që, nuk kanë përse vetëdeklarohen. Çfarë duhet të provojë ministria me kërkesën për vetëdeklarim, mbi dokumente që i ka nxjerrë, njoftuar dhe arkivuar po vetë?!

Sikurse dhe me të dhënat vetëdeklaruese të CV-së (!) p.sh mbi statusin familjar apo librezën e punës para certifikimit si përmbarues (!), që janë kërkesa për të dhëna personale që nuk lidhen asfare pak me profesionin dhe për më shumë, që nuk janë pasqyruar në asnjë pikë të nenit 23 të ligjit nr. 26/2019.

Në lidhje me formularin e **vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore**, gjithashtu, ky formular vetëdeklarimi nuk është i parashikuar në asnjë dispozitë ligjore të ligjit, ndaj dhe depozitimi i këtij formulari përforcon konstatimin e Dhomës se, qëllimi i aktit normativ nuk orientohet në përditësimin e të dhënave të dosjeve përmbarimore, por procesi i “vettingu” nëpërmjet formularëve të vetëdeklarimit synon **kontrollin në formë shantazhi** dokumentar të përmbaruesve gjyqësorë privatë nëpërmjet këtij procesi. I njëjti proces shantazhist dokumentar ka ndodhur edhe me shërbimin noterial shqiptar. Themi në formë shantazhi, **sepse** edhe për shërbimin noterial, sipas komunikimeve që kemi patur me noterë apo Dhomën Kombëtare të Noterisë, bëhemi me dije se, që nga prilli 2019 është nisur një formë procesi “vetting” të noterëve, që kryhet nga **stafi këshillimor i ministres së Drejtësisë**, në bashkëpunim me disa nëpunës të kësaj ministrie. Ky “grup pune” thërret noterë për t’u treguar si janë “bërë noterë” në mënyrë të paligjshme, ndërkohë që për mbi 1 vit, jashtë çdo rregulli procedural dhe afati, ky proces nuk është përfunduar për asnjë prej noterëve të vetuar; nuk ka prodhuar dhe nuk ka si të prodhojë asnjë efekt ligjor mbi ta, madje edhe për ata që vërtet mund të jenë licencuar në kundërshtim me ligjin. Procesi “vetting” i noterëve po mbahet ende zvarrë për arsye të ndryshme nga kërkesat e ligjit.

Në këtë pikë duhet të theksohet se, në shkronjën “b” të nenit 14 të ligjit nr. 26/2019 është parashikuar kontrolli i zbatimit të ligjit organik dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore, lidhur me veprimtarinë e përmbaruesve gjyqësorë privatë, kontroll i cili kryhet në mënyrë të pavarur nga procesi i “vettingu” që synohet nëpërmjet këtij urdhri ministror.

Qëllimi kontrollues antiligjor ministror, evidentohet në pikën 5 të urdhrin, që ka parashikuar se:

“...Pasqyrimi i të dhënave të rreme në formularët e vetëdeklarimit, fshehja ose mosdeklarimi i të dhënave që janë të detyrueshme për t’u deklaruar sipas këtij urdhri ose ligjit për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat pavarësisht nëse përbën vepër penale, në çdo rast përbën shkak për nisjen e procedimit disiplinor...”

Në ligjin nr. 26/2019 nuk është parashikuar në asnjë dispozitë të tij përcaktimi i ndonjë lloji të përgjegjësisë penale, në rast mosdeklarimi. Për më tepër ndaj “të dhënave të rreme”.

Urdhri mbyllet me pikën 12, në të cilën theksohet dhe një herë zbatimi i urdhrin në lidhje me detyrimin për rifreskimin e dosjeve personale, duke vënë theksin e dorëzimit të formularëve të

vetëdeklarimit, të cilët parashikojnë të dhëna që nuk janë parashikuar fare në nenin 23 të ligjit nr. 26/2019, apo të dhëna që lidhen me veprimtarinë e drejtpërdrejtë administrative të ministrit të Drejtësisë, që ka detyrimin ligjor të përditësimit të të dhënave me aktet që ka nxjerrë ky organ administrativ.

Në kushtet kur urdhri nr. 190, datë 22.6.2020 konstatohet që nuk është nxjerrë në përputhje me qëllimin që ka parashikuar neni 23 dhe neni 88/7 i ligjit 26/2019 atëherë për pasojë të drejtpërdrejtë, ky urdhër është nxjerrë në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë të parashikuar në pikën 1, të nenit 4, të Kodit të Procedurave Administrative që përcakton se:

“...Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca...”.

Ky urdhër është i paligjshëm edhe për shkak se nuk ka zbatuar detyrimin Kushtetues të parashikuar në pikën 2 të nenit 118 të Kushtetutës, në lidhje me çështjen e autorizuar nga ligji që duhej të rregullonte ministri i Drejtësisë.

Pika 1 e aktit përcakton qëllimin e aktit, por kjo pikë nuk ka asnjë lidhje me nenet vijuese që duhet të dilnin në përputhje me qëllimin që ka synuar vetë akti, citojmë pikën 1:

“...Përmbaruesit gjyqësorë privatë kanë detyrimin të dorëzojnë pranë Ministrisë së Drejtësisë, dosjen personale të plotë të rifreskuar, sipas përcaktimeve të këtij urdhri...”.

Pikat 3, 5 dhe 12 të urdhrit nr. 190, datë 22.6.2020 përcaktojnë një qëllim të ndryshëm nga qëllimi i aktit të parashikuar në pikën 1 të tij, pa të cilin ky akt nuk mund të prodhojë efektet e parashikuara.

Në këto kushte këto pika të aktit janë aq të rëndësishme, saqë organi publik nuk do të kishte nxjerrë urdhrin pa përcaktuar këto pika dhe për këtë arsye në zbatim të nenit 110/3 të Kodit Procedurave Administrative kërkojmë që i gjithë akti **të konstatohet absolutisht i pavlefshëm**.

vi. Pasaktësi ligjore në përmbajtje të urdhrit

Pasaktësia ligjore e urdhrit konsiston në përplasjen e 2 pikave të tij. Konkretisht pika 5 dhe pika 6 e urdhrit nr. 190, datë 22.6.2020.

Në pikën 6 është parashikuar si vijon:

“...Në rastet kur dokumentacioni i dorëzuar që përbën dosjen personale të rifreskuar vërehen mangësi, struktura përgjegjëse i kërkon përmbaruesit gjyqësor privat, plotësimin e mangësive brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit...”.

Për mënyrën se si janë formuluar këto dy pika, akti është i paqartë dhe nuk bën dallimin se në cilin rast do të konsiderohet fshehje dhe mosdeklarim i të dhënave që janë të detyrueshme dhe në cilin rast do të konsiderohet mangësi në dokumentacionin e dorëzuar, duke ritheksuar se vetëdeklarimi /deklarimi sipas përcaktimit ligjor lidhet me detyrimin e përmbaruesve gjyqësorë privatë për të deklaruar regjistrimin e të gjitha të dhënave të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të nenit 23 të ligjit nr. 26/2019.

Kjo paqartësi e aktit normativ cenon formën e aktit për shkak të paqartësisë së tij.

vii. Kërkimi mbi masën e sigurimit të padisë, shkaktimi i dëmit serioz, të menjëhershëm, të rëndë dhe të pariparueshëm nga ekzekutimi i aktit administrativ

Për të përligjur kërkesën për marrjen e masës së sigurimit të padisë, do të referohemi tek pika 2 dhe pika 9 e urdhrit nr. 190, datë 22.6, 2020 “Për miratimin e listës së dokumenteve dhe formatit të vetëdeklarimit për rifreskimin e dosjeve personale të përmbaruesve gjyqësorë privatë”.

Citojmë pikat e urdhrit:

“...2. Dosja e plotë e dokumentacionit të përmbaruesit, sipas përcaktimeve të këtij urdhri, depozitohet brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e tij, në adresën të Ministrisë së Drejtësisë...”

“...9. Mosrespektimi i kërkesave të këtij urdhri nga përmbaruesi brenda afatit të përcaktuar, përbën shkak për nisjen e procedimit disiplinor, në përputhje me legjislacionin në fuqi....”.

Zbatimi i këtij urdhri do të mundësonte procesin e rivlerësimit të të gjithë përmbaruesve gjyqësorë privatë, proces i cili nuk është parashikuar në ligj dhe për këtë shkak është i paligjshëm.

Nga ana tjetër, moszbatimi i urdhrit për shkak të pavlefshmërisë absolute dhe pasojat që sjell në veprim i tillë sipas pikës 9 që konsiston në nisjen e procedimit disiplinor ndaj përmbaruesve gjyqësorë privatë, bashkë me procesin “vetting” = të rivlerësimit të përmbaruesve gjyqësorë privatë që synon urdhri, plotëson në mënyrë kumulative të gjitha kushtet ligjore të nenit 29 të ligjit nr. 49/2012, që ka përcaktuar se kriteri kryesor për marrjen e masës së sigurimit të padisë është se, duhet të ekzistojë një dyshim i arsyeshëm për mundësinë e shkakut të dëmit të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëcastshëm.

Zbatimi i urdhrit nr. 190, datë 22.6, 2020 “Për miratimin e listës së dokumenteve dhe formatit të vetëdeklarimit për rifreskimin e dosjeve personale të përmbaruesve gjyqësorë privatë” dhe mosshfuqizimi i këtij akti nënligjor nga gjykata, do të sillte nisjen e procedimit disiplinor, duke shkaktuar dëm të rëndë pasi, i gjithë procesi do të devijonte qëllimin e ligjit nga përditësimi /rifreskimi i dosjeve bazuar në të dhëna të kërkuara sipas parashikimeve ligjore, në një proces rivlerësimi bazuar në vetëdeklarime, i cili pavarësisht mundësisë së konstatimit të pavlefshmërisë absolute, sjell pasojat direkte.

Nëse përmbaruesit nuk do të zbatojnë këtë urdhër në zbatim të nenit 84 të ligjit 26/2019 “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat” moszbatimi i urdhrit do të konsiderohej shkelje disiplinore dhe në zbatim të pikës 1 të nenit 85 të këtij ligji, përmbaruesit gjyqësorë privatë mund të penalizoheshin me njërën nga masat disiplinore të sanksionuara nga kjo dispozitë.

Sa më sipër, vetë procesi i përditësimit/rifreskimit të dosjeve do të komprometohej rëndë (ashtu si ndodhi me shërbimin noterial shqiptar (sot dhe prej mbi 1 vit), ndërsa përmbaruesit gjyqësorë privatë do të cenoheshin rëndë nga ky proces.

Moszbatimi i urdhrit nr. 190, datë 22.6, 2020 do të shkaktojte **dëm të atëcastshëm**, pasi në pikën 9 është parashikuar se:

“9. Mosrespektimi i kërkesave të këtij urdhri nga përmbaruesi brenda afatit të përcaktuar, përbën shkak për nisjen e procedimit disiplinor, në përputhje me legjislacionin në fuqi [...]”.

Në zbatim të kësaj pike, procesi i **“vettingut”= të rivlerësimit** të përmbaruesve do të fillonte në afatin 30-ditor nga marrja e njoftimit, që do të thotë se, plotësimi i vetëdeklarimeve sipas urdhrit, do të synonte një qëllim të ndryshëm nga dispozita ligjore, që lidhet me një proces ilegjitim dhe me mundësinë e nisjes së procedimeve disiplinore.

Në lidhje me mundësinë e rikuperimit të dëmit në një periudhë të mëvonshme, duhet të theksojmë se, akti normativ konsiderohet i vlefshëm deri në momentin që bëhet shfuqizimi i tij dhe për këtë arsye dëmi i shkaktuar në statusin e përmbaruesit gjyqësor privat, mund të jetë i **parikuperueshëm**, nëse penalizohet me masa disiplinore, në zbatim të këtij urdhri.

Nga pezullimi i aktit normativ nuk cenohet asnjë interes publik, sepse pavarësisht synimit që ka ministri i Drejtësisë për të **“vetuar=riverifikuar”** dokumentacionin e dosjeve personale të përmbaruesit gjyqësorë privatë, **rivlerësimin e synuar dokumentar** të dosjeve personale të përmbaruesve gjyqësorë privatë mund ta kryejë dhe me dokumentet ekzistuese që tashmë janë të administruara si dosje personale të përmbaruesve gjyqësorë privatë, pranë Ministrisë së Drejtësisë që në momentin e certifikimit, betimit dhe nisjes së aktivitetit të tyre dhe në vazhdim.

- **Dhënia e masës së përkohshme për pezullimin e aktit administrativ mbron interesin publik, për shkak se, do të mundësonte një “Regjistër të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë” dhe një “Regjistër Unik të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë”, bazuar në ligj dhe jo në vetëdeklarime me synime të “vettingut” artificial dhe antiligjor.**

Akti administrativ 190, datë 22.6, 2020 në kushtet kur:

- bie ndesh me procedurën në fazën e përgatitjes së aktit administrativ;
- është nxjerrë në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë të përcaktuar në nenin 4 të Kodit të Procedurave Administrative;
- përbën një akt administrativ të paqartë që cenon formën e kërkuar nga ligji;

- qëllimi i urdhrit nuk duhet të synonte kryerjen e procesit të “vettingut” artificial në shërbimin përmbartimor gjyqësor privat, por përditësimin e të dhënave nëpërmjet deklarimit të regjistrimit të tyre pranë Ministrisë së Drejtësisë;
- zbatimi i këtij urdhri dhe procesi artificial “vettingu” do të shkaktonte një dëm serioz, të pariparueshëm, të pakthyeshëm për përmbartuesit gjyqësorë privatë dhe/ose zyrtat përmbartimore.

Sa më sipër, parashtrohet me urgjencë **nevoja e marrjen se masës së sigurimit të padisë** sipas nenit 30/a, të ligjit nr. 49/2012 për pezullimin e zbatimit të aktit administrativ nr. 190, datë 22.6, 2020 “Për miratimin e listës së dokumenteve dhe formatit të vetëdeklarimit për rifreskimin e dosjeve personale të përmbartuesve gjyqësorë privatë”.

Duke qenë se kërkesëpadia është e bazuar në ligj dhe në prova, përfundimisht,

KËRKOJMË:

- Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke vendosur pezullimin e zbatimit të aktit administrativ, urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 190, datë 22.6.2020 “Për miratimin e listës së dokumenteve dhe formatit të vetëdeklarimit për rifreskimin e dosjeve personale të përmbartuesve gjyqësorë privatë”.
- Pranimin e plotë të kërkesëpadisë, shfuqizimi e aktit administrativ, urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 190, datë 22.6.2020 “Për miratimin e listës së dokumenteve dhe formatit të vetëdeklarimit për rifreskimin e dosjeve personale të përmbartuesve gjyqësorë privatë”.

Lista e provave që i bashkëlidhen kërkesëpadisë:

1. Shkresa “Për njohje dhe zbatim” nr. 3778/1 prot., datë 24.6.2020 e Ministrisë së Drejtësisë;
2. Shkresë e DHKPGJP-së, nr. 615 prot., datë 2.10.2019 (propozimi i Dhomës);
3. Shkresë e DHKPGJP-së nr. 671 prot., datë 13.5.2020 (përcjellje mendimi);
4. Shkresë e DHKPGJP-së nr. 695 prot., datë 3.7.2020.

Paditësi

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARTUESVE GJYQËSORË PRIVATË

Përfaqësuar nga

KRYETARI

TEDI MALAVECI



14